



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	07.12.2017
Referencë	11-344/11
Për :	Kryetar i Komunes- Imri Ahmeti
Përmes :	Drejtpërsëdrejti
Nga :	Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rrustemi
Lënda :	RAPORTI MUJOR-NENTOR

## Pasqyra tabelare e punës për muajin – NENTOR

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Mbyllje e përkohëshme	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Inspektime të përbashkëta	Pëlqime sanitare	Vendosje e shiritav zyrtar	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime- ndalesa, urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Gjaba mandatore	Inspektim i kafshëve në thetore	Inspektime me polici	Inspektim i tokave bujqësore	Biznese të paregjistruara dhe pa pranime teknike	Mali i pa përshtatshëm për konsum	Të hyrat nga pranimet teknike të lokaleve afariste
Biznesit	315	36	9	3		25	13		25				8	56	119					31		275€
Ambientit	215	20		2		3			88					1	99		2					
Bujqësisë	182	16				40			22						44				60			
Ndërtimtarisë	46	16							12					5	13							
Trafikut	292	17				58	3		30			108	8		27			41				
Sanitar	164	17		2	49	26	1		63	1				1	3		1					
<b>Gjithsejtë</b>	<b>1214</b>	<b>122</b>	<b>9</b>	<b>7</b>	<b>49</b>	<b>152</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>240</b>	<b>1</b>		<b>108</b>	<b>16</b>	<b>63</b>	<b>305</b>		<b>1</b>	<b>43</b>	<b>60</b>	<b>31</b>		<b>275€</b>

Gjatë muajit Nëntor kemi hasur në biznese të pa regjistruara ku janë urdhëruar me procesverbal dhe me aktvendim që të bëjnë regjistrimin e tyre pranë qendrese së regjistrimit të bizneseve ARBK-së, Lipjan gjithashtu kemi pasur biznese pa pranime teknik të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjienike ku janë urdhëruar me procesverbal dhe aktvendim që të aplikojnë pranë Drejtoratit të Inspektoratit tek inspektorët e tregut. Po ashtu për mos respektim të urdhëresave janë mbyllur 3 subjekte ekonomike përkohësisht deri në eliminimin e parregullsive të konstatuara me procesverbal. Në bazë të kërkesave të bizneseve kemi bërë pranime teknike me procesverbal për plotësimin e kushteve tekniko minimale për të ushtruar veprimtarin ekonomike, kemi bërë barazimin e të hyrave nga pranimet teknik në vlerë prej 275.00 €.

Gjatë muajit është bërë inspektimi i disa subjekteve afariste si kafe, fast food, po ashtu është bërë inspektimi i disa furrave të bukës, të gjitha këto janë inspektuar në aspektin higjieno sanitarë dhe për të gjitha mangësitë është dhënë urdhër me procesverbal për eliminimin e mangësive.

Janë kontrolluar deponitë ilegale të mbeturinave, ku është takuar një biznese duke hedhë mbeturina inerte tek ura e Lumit Sitnica ndaj të cili janë marrë masat e duhura ligjore.

Një biznesit i cili është duke ushtruar veprimtarin tek ish Fabrika e Letrës për shkak të hedhjes së një materiali i quajtur Pet Koks afër bunarëve dhe rrezikut nga ndotja i ujit të pijes, i është dhënë urdhëresë për largim dhe ndaj tij është iniciuar fletëparaqitje për gjykatë. Gjithashtu një fletëparaqitje është bërë edhe për një biznes tjetër, për shkak të ndezjes së mbeturinave dhe mos respektim të urdhëresës së dhënë.

Është dalë në vendin e ngjarjes sipas ankesave në disa fshatra si në fsh. Glllogvc, Rubovc, Ribar i Madh dhe në Qytet, ndërsa në f.sh Banullë është inspektuar sipas ankesave në lidhje me ndotje të lumit për shkak të shkarkimit të ujërave të zeza, mbeturinave të hedhura nga disa qytetarë të pandërgjegjshëm, e që ndaj tyre janë marrë masat e duhura ligjore. Kemi bashkëpunuar me ujësjellësin KUR Prishtina duke e njoftuar për problemet me ujëra të zeza si pasojë e mbylljes së gypave të kanalizimit në f.sh Glllogoc dhe Shalë.

Është inspektuar në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Vrellë në bashkëpunim me policin kufitare për auto-taksi të cilët po tentojnë të ushtrojnë veprimtari ilegale, është bërë inspektimi i kompanive të autobusëve të cilët operojnë në territorin e Lipjanit se mos ka ndonjë vonesë në rendë të udhëtimit, si dhe kontrollimi i auto-taksive që janë të parkuar në parkingjet e auto-taksit si në rrugën Lidhja e Prizrenit, Isa Olluri dhe Skënderbeu, se po hasim ndonjë duke ushtruar veprimtari ilegale.

Gjatë këtij muaji janë bërë inspektime mbi tokat Bujqësore në regjione të ndryshëm të Komunës ku janë fokusuar ndërrim-destinimet e tokës Bujqësore, janë inspektuar Barnatoret Bujqësore mbi dokumentacionin përkatës për importim dhe distribuim të farërave dhe plehrave pasi që jemi në sezonin e mbjelljeve vjeshtore sipas ligjeve përkatëse .

Janë inspektuar disa objekte të ndërtimi dhe inspektuar lokacionet e vend ndërtimeve në terren, gjendja e ndërtimeve është nënë kontrollin e vazhdueshëm inspektues në zonën urbanistike dhe zonat tjera ndërtuese, objekteve pa leje ndërtimi gjatë këtij muaji është identifikuar një (1) të cilit i është dhënë urdhëresë me Aktvendim dhe i është ndaluar puna e ndërtimit-objekt i cili është në procedurë të marrjes së lejes ndërtimore.

Të gjitha inspektimet e realizuara gjatë këtij muaji në objektet e ndërtimit, rezultojnë të pajisura me leje ndërtimore, konform Ligjit të Ndërtimit.